



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
URDHRI I PSIKOLOGUT
KËSHILLI KOMBTËAR



Tiranë më, 03.04.2025

V E N D I M

Nr. 8, datë 03.04.2025

Sot më datë 03.04.2025, Keshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut, i thirrur nga Presidenti, mori në shqyrtim në rendin e ditës:

- Shqyrtimi i kërkesës së Zyrës Përmbarimore Tiranë për pezullimin e masës së dhënë nga Komisioni Etik dhe Gjykit Disiplinor Profesional me vendimin nr.10 datë 06.09.2024 dhe lënë në fuqi nga Këshilli Kombëtar me vendimin nr.16 datë 09.10.2024 për psikologun Z. Altin Nika.

KËSHILLI KOMBTËAR KONSTATOI SE:

Bazuar nga sa më sipër, është konstatuar se ndaj Psikologut Z. Altin Nika ka një masë disiplinore, konkretisht vendimi nr.10 datë 06.09.2024 të Komisionit Etik të Gjykit Disiplinor Profesional dhe lënë në fuqi me vendimin nr.16 datë 09.10.2024 të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut, i cili nuk është shfuqizuar nga Gjykata me vendim të formës së prerë. Ekzekutimi i kësaj mase është pezulluar me vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me nr.10868, datë 15.11.2024. Duke qenë se nga Zyra e Përmbarimit kërkohet formalisht nxjerrja e një akti të brendshëm pezullimi për ndërprerjen e zbatimit të vendimeve të lartëpërmendur, Këshilli Kombëtar

PËR KËTO ARSYE, VENDOSI:


- 1- Të miratojë me 10 (dhjetë) vota Pro, Asnjë Kundër nga anëtarët prezent në mbledhje të Këshillit Kombëtar se masa disiplinore kundrejt psikologut Z. Altin Nika, ndonëse mbetet në fuqi deri në shqyrtimin e çështjes në themel nga gjykata, nuk mund të ekzekutohet.

PRESIDENTE E URDHRI

Dr. Valbona TRESKA

SEKRETARE

Arlinda KËÇI



Bla. Gjergj Fishta, Ndërtesa nr. 26, kati II, Ap.9, Tiranë
Email: sekretaria@urdhriipsikologut.al, Tel.: 0035542209927